



# NEWSLETTER

JANAR - MARS 2024

## Raporti Vjetor 2023 i ERRU-së shqyrtohet në komisionin parlamentar

Në përmbushje të detyrimit ligjor dhe rezolutës me rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë, Enti Rregullator i Ujit prezantoi në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin Raportin Vjetor të aktivitetit të tij për vitin 2023, si dhe mbi performancën dhe zhvillimet kryesore në sektorin ujësjellës kanalizime. Në fjalën e mbajtur përpara deputetëve të komisionit, kryetari i ERRU, Z. Ndriçim Shani bëri një pasqyrim të veprimtarisë së institucionit për vitin 2023 duke veçuar reformën e agregimit, e cila ka hyrë në fazën e saj përfundimtare. Në këtë proces, ERRU ka luajtur një rol aktiv në drejtim të licencimit dhe tarifave të reja të propozuara nga shoqëritë rajonale si dhe realizimin me sukses të saj duke aplikuar zgjidhje elastike të problematikave komplekse që lindën gjatë implementimit. Nga 58 shoqëri UK që operonin më parë, deri në fund të vitit 2023 janë konkretizuar 14 shoqëri UK Rajonale. Për arsye teknike, akoma nuk është krijuar Shoqëria Rajonale UK Tiranë që përfshin bashkitë Tiranë, Kamzë dhe Vorë. Gjatë vitit 2023, ERRU ka miratuar licencat për 16 shoqëri UK, 11 prej të cilave si shoqëri rajonale të krijuara sipas reformës. Në lidhje me tarifën, pranë ERRU janë paraqitur shtatë aplikime të reja, tre prej të cilave u refuzuan për mangësi në dokumentacion. Enti po ndjek më vëmendje procesin e unifikimit të tarifave të shoqërive UK brenda një shoqërie rajonale duke studiuar mundësitë e realizimit për shkak të diferencave të mëdha. Procesi i riorganizimit ka hasur edhe në problematika të tjera si: mosrakordimi i detyrimeve të prapambetura kontraktuale të shoqërive të mëparshme ekzistuese; mosrakordim i numrit të klientëve debitorë në sistem me ato të pasqyruara në bilancet financiare të shoqërive si dhe mungesa në dokumentacionet e mbartura nga shoqëritë individuale të mëparshme.

### PËRMBAJTJA

- RAPORTI VJETOR
- VENDIMMARRJA E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR
- PJESËMARRJA NË AKTIVITETE
- ARTIKUJ STUDIMORË



Relatori i raportit, Z. Baftjar Zeqaj e konsideroi raportin e paraqitur shterrues, duke e cilësuar Entin si një institucion që po realizon me përgjegjshmëri procesin e licencimit dhe tarifave gjatë reformës së agregimit. Nën drejtimin e kryetarit, Z. Arben Pëllumbi, deputetët e këtij Komisioni bënë pyetje dhe komentet e tyre, të cilat u adresuan nga kreu i ERRU.

## VENDIMARRJA E KKRR

Në 3-mujorin e parë të vitit 2024, Komisioni Kombëtar Rregullator ka zhvilluar pesë mbledhje duke marrë 10 vendime, midis të cilave veçohen:

- ✓ Detajimi i planit të shpenzimeve operative të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2024
- ✓ Miratimi i programit vjetor të shërbimeve jashtë vendit të Entit Rregullator të Ujit për vitin 2024
- ✓ Miratimin e Raportit Vjetor të aktiviteit të ERRU-së për vitin 2023
- ✓ Caktimin e Znj. Ediola Braha, zëvendëskryetar të Komisionit Kombëtar Rregullator të ERRU
- ✓ Vendim për rinovim licence të Shoqërisë Rajonale UK Shkodër për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor
- ✓ Vendim për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Lezhë sh.a

### LICENCIME

Prej vitit 2022, sektori i ujit është në proces reformimi, ku 58 shoqëri individuale ekzistuese duhet të riorganizohen në 15 shoqëri rajonale. Derimë tani janë licencuar nga ERRU 13 shoqëri rajonale dhe mbeten akoma për t'u licencuar edhe dy shoqëri rajonale, përkatësisht: UK Tirana (Tiranë, Vorë, Kamëz) dhe UK Vlorë (Vlorë, Selenicë, Himarë). Në 3-mujorin e parë të 2024, pranë ERRU është paraqitur dhe aprovuar kërkesa për rinovim licence e Shoqërisë Rajonale UK Shkodër, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor.

### TARIFA

Me reformimin e sektorit të ujit, shtatë shoqëri UK aplikuan për nivel të ri tarifor, gjashtë prej të cilave si shoqëri rajonale dhe një shoqëri ekzistuese. Tre prej tyre: UK Shkodër, UK Elbasan dhe UK Berat u refuzuan për arsye të mungesës së dokumentacionit të detyrueshëm. Në fund të 2023, KKRR miratoi tarifatat e propozuara nga UK Vlorë, ndërsa në 3-mujorin e parë të këtij viti ka miratuar një vendim për nivel të ri tarifor, konkretisht për Shoqërinë Rajonale UK Lezhë dhe ka në proces analize Shoqërinë Rajonale Fier dhe Shoqërinë Rajonale Durrës.

# PJESËMARRJA NË AKTIVITETE



## Gjeoinxhinieria e ujërave, ERRU merr pjesë në Konferencën e Akademisë së Shkencave

Në 29 mars, Enti Rregullator i Ujit u bë pjesë e Konferencës së parë Kombëtare për ujërat të organizuar nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë me temë: “Gjeoinxhinieria e Ujërave Sipërfaqësore dhe Nëntokësore në Republikën e Shqipërisë - Alternativat për ruajtjen dhe miradministrimin e tyre”.

Kryetari i Entit Rregullator të Ujit, Z. Ndriçim Shani moderoi sesionin e dytë të konferencës, “Menaxhimi i integruar i burimeve ujore në Shqipëri dhe Kosovë” ku u prezantuan 13 kumtesa mbi menaxhimin e burimeve ujore dhe lidhja e tyre me ekosistemet përkatëse. Midis tyre, edhe një prezantim i ERRU: “Parimet e vendosjes së tarifave në Evropë dhe Shqipëri” prezantuar nga Z. Shani, në të cilin u analizuan parimet bazë të Direktivës Kuadër të Ujit në Bashkimin Evropian “Rikuperimi i kostove” dhe “Ndotësi paguan” si dhe sfida e vendit tonë për një sektor jo vetëm të qëndrueshëm financiarisht, por edhe në një linjë me normat e BE-së. Përmirësimi i Treguesve Kryesorë të Performancës si dhe në veçanti rrugët për përmirësimin e performances financiare nga shoqëritë janë disa nga sfidat kryesore të fazës së tranzicionit të sektorit të ujit. Qeveria qendrore, sipas z. Shani duhet gjithashtu të luajë rolin e saj që të balancojë elementët e qëndrueshmërisë financiare me ato të barazisë sociale për shërbimet e ujit. Konferenca adresoi çështje shumë të rëndësishme dhe aktuale në fushën e ujit duke propozuar zgjidhje të argumentuara nga pjesëmarrësit që ishin akademikë, profesorë, inxhinierë dhe kërkues të fushës, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe agjencie politikëbërëse e zbatuese në sektorin e ujit.

## “KEP Project”, përmbyllet cikli i seminareve për ngritjen e kapaciteteve

Rregullatorët ekonomikë të ujit në Ballkanin Perëndimor, kandidatë për t’u anëtarësuar në Bashkimin Evropian: Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi u mbledhën në 27 shkurt në Bruksel në një takim duke përmbyllur ciklin e seminareve të projektit për ngritjen e kapaciteteve të stafeve rregullatore, të cilat vijnë në mbështetje të procesit të integritimit evropian.

Në takim morën pjesë stafi i Sektorit Ekonomik dhe Tarifave, të kryesuar nga drejtori i Drejtorisë Teknike-Ekonomike, Z. Sokol Kraja, i cili bashkë me përfaqësuesit në Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi prezantuan situatën dhe sfidat rregullatore në vendet respektive. Për Shqipërinë, reforma e agregimit të sektorit, mbledhja e të dhënave të sakta e të besueshme, rritja e kapaciteteve të stafit dhe metodologjia e caktimit të tarifave janë sfidat kryesore që bartin të tjera pengesa si: diferencat në cilësinë dhe tarifat e shërbimit brenda një shoqërie rajonale, nevoja për burime njerëzore të kualifikuara e mjete financiare për investimet e nevojshme.



### AKTIVITETET E RADHES:

- 15 - 17 prill - Takim pune ERRU-ARRU (Autoriteti Rregullator i Kosovës), Kosovë
- 22-24 prill - Asambleja e 31-të e WAREG, Firenze, Itali
- 29- 30 maj - Forumi i Ujit të Danubit, Brasov, Rumani

## “Transformimi Dixhital në Sektorin UK”

Artikull nga:

Ndriçim Shani, ERRU

Klevis Jahaj, AKUK



Dixhitalizimi si koncept përfaqëson adaptimet përkatëse të realizuara për të operuar një sistem ose proces me anë të përdorimit të kompjuterit dhe internetit. Në një shoqëri UK, transformimi dixhital përfshin zbatimin e instrumenteve praktike, software, hardware që mundësojnë rritjen e efikasitetit në menaxhimin të operimit teknik në sistemet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të ujërave të ndotura, përfshirë edhe shërbimet ndaj klientit. Dixhitalizimi në përgjithësi ndihmon shoqëritë dhe aksionerët e tyre përkatës (qeveria qendrore dhe bashkitë) që të kuptojnë më mirë aspektet e Kërkesës për Ujë, të identifikojnë problemet dhe mundësitë e reduktimit të humbjeve dhe optimizimit të përdorimit të ujit, të aplikimit të principeve të ripërdorimit të ujit dhe ekonomisë qarkulluese, si dhe për hartimin e strategjive efektive të menaxhimit të ujit. Këto teknologji mundësojnë monitorimin në kohë reale, si dhe në dhënien e një përgjigje të shpejtë ndaj problemeve të cilësisë së ujit dhe emergjencave. Në këtë kuptim Transformimi Dixhital në sektorin e ujit mund të luajë një rol kyç për përshpejtimin e progresit të përmbushjes Objektivit të Zhvillimit të Qëndrueshëm nr.6 (SDG nr. 6) për një menaxhim të sigurt të ujit të pijshëm dhe ujërave të ndotura, si edhe për përmirësimin e performancës financiare të shoqërive UK. Për artikullin e plotë lexoni <https://erru.al/2024/02/06/transformimi-dixhital-ne-sektorin-e-ujesjelles-kanalizimeve/>

## Parimet e Vendosjes së Tarifave në Europë dhe Shqipëri

Artikull nga:

Ndriçim Shani, Kryetar i ERRU

Uji është një burim jetik për ekzistencën njerëzore, aktivitetin e tij ekonomik dhe ruajtjen e mjedisit. Dy parimet thelbësore në përbërje të legjislacionit të BE-së për ujërat janë, respektivisht Parimi i Rikuperimit të Kostos dhe Parimi Ndotësi Pagan. Dy parimeve bazë mund ti bashkëngjiten edhe parime të tjera ndihmëse, por jo më pak të rëndësishme, si Efienca Ekonomike, Mbrojtja e Mjedisit dhe Barazia Sociale. Politikat e menaxhimit të ujit natyrisht janë të lidhura ngushtësisht me Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore, ku përveç plotësimit të nevojave për pirje parashikohen edhe kërkesat e përdoruesve të tjerë të ujit për nevoja të bujqësisë, peshkimit, me argëtimet në fushën e ujit etj. Legjislacioni i BE jep të zhvilluara konceptet mbi parimin bazë të Rikuperimit të Kostos, në përputhje me të cilën më poshtë përshkruhet gjendja dhe perspektiva e zbatimit të tij në Shqipëri në sektorin e ujësjetllës kanalizimeve në plotësim të kushteve për “acquis communautaire” në kuadër të bashkimit të vendit tonë me Komunitetin Europian. Për artikullin e plotë lexoni: <https://erru.al/wp-content/uploads/2024/03/Parimet-e-Vendosjes-se-Tarifave-ne-Europe-dhe-Shqiperi.pdf>



Rr: "Viktor Eftimiu", Ndërtesa 1,  
Kati IV, Njësia Administrative  
Nr. 5, 1022, Tiranë, Shqipëri



TEL:  
+355 42 258 046



EMAIL:  
public@erru.al